



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU
981
D
25.11.2024

DATË/A	25.11.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Humbjet e Ujit

Të nderuar,

Në vitin 2018 ARRU iu shkroi të gjithë KRU-ve duke i udhëzuar të ndërmarrin masat e nevojshme për të trajtuar nivelet e larta të humbjeve të ujit. Në këtë letër ARRU pati kërkuar nga KRU-të të ndërmarrin analiza të hollësishme inxhinierie për të përcaktuar natyrën e humbjeve dhe ndikimin financiar të tyre, dhe një strategji për të reduktuar humbjet në nivelin më të ulët ekonomik.

Pavarësisht nga kërkesat e mëhershme të ARRU-së që KRU-të të trajtojnë çështjen e humbjeve, nuk janë ndërmarrë veprime materiale dhe humbjet vazhdojnë të rriten. Informacioni i fundit që KRU-të kanë raportuar sugjeron se humbjet totale në të shtatë KRU-të arrijnë mbi 110 milion m³ ujë në vit.

Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë ndarjen e këtyre humbjeve, midis humbjeve komerciale (konsumit të pamatur dhe/ose të paligjshëm dhe leximeve të gabuara të matësve) dhe humbjeve teknike (rrjedhjeve në rrjet) para se KRU-të të ndërmarrin të paktën disa hulumtime paraprake inxhinierie. Vlerësimi ynë intuitiv është se 50% - 60% e humbjeve të përgjithshme në të gjitha KRU-të mund të jenë humbje komerciale, por me dallime të mëdha midis KRU-ve individuale. Me nivelin aktual tarifor ARRU vlerëson se vlera financiare e këtyre humbjeve komerciale është më shumë se 20 milionë EUR në vit. Ky vlerësim supozon se këto humbje i atribuohen vetëm konsumatorëve shtëpiak dhe nuk përfshin të ardhurat potenciale nga ngarkesat fikse shtesë, nga rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Rrjedhimisht, për të ardhura shtesë nga taksa fikse dhe që një pjesë e humbjeve mund të atribuohet konsumit prej konsumatorëve jo-shtëpiak, ne konsiderojmë se vlerësimi i humbjeve financiare ka mundësi të jetë më i vogël.

Dështimi i KRU-ve për të trajtuar humbjet iu vendosë ngarkesa më të larta konsumatorëve. Prandaj, ne propozojmë të përfshijmë në modelin tarifor pritjet për përmirësim të efijencës komerciale përmes reduktimit realist, por sfidues, të humbjeve komerciale (aparente) në shqyrtimin tarifor 2026-2028. Ky planifikim i reduktimit të humbjeve komerciale do t'i shtohet shitjeve të përgjithshme të ujit të cilat do të ndikojnë që tarifatat të jenë më të ulëta se sa do të ishin, d.m.th.

Metodologjia aktuale: Tarifa = Kërkesa për të ardhura (EUR) / Shitje (m³)

Metodologjia e propozuar: Tarifa = Kërkesa për të ardhura (EUR) / (Shitjet + reduktimi i humbjeve të dukshme) (m³).

Vendimi ynë për nivelin (volumin) e humbjeve aparente që do të reduktohen gjatë periudhës së ardhshme tre-vjeçare të shqyrtimit tarifor do të bazohet në prova (evidencë) të verifikueshme të siguruar nga KRU-të. Këto evidenca do të përfshijnë rezultatet e analizave preliminare mbi shkallën dhe natyrën e humbjeve në sistemet e KRU-ve dhe duke pasur në konsideratë përlllogaritjet kohore për zbatimin. Ne nuk shohim arsye pse humbjet komerciale të mos reduktohen në nivele pothuajse zero në afat më të gjatë.

Prandaj, ARRU kërkon nga KRU-të të ndërmarrin hulumtime paraprake për të përcaktuar pjesëmarrjen e humbjeve aparente (komerciale) dhe teknike në humbjet e përgjithshme. Kjo mund të përfshijë hulumtime inxhinierike të tilla si testet e rrjedhjes gjatë natës për të përcaktuar humbjet teknike, të cilat, nga ana e tyre, mund të përdoren për të nxjerrë një vlerësim të parë të humbjeve aparente (komerciale). Aktivitete të tilla kur realizohen në zona të matura të ujit (DMA-District Metered Areas) jo vetëm që do të identifikojnë shkallën dhe llojin e humbjeve, por edhe vendndodhjen e tyre. Kjo punë duhet të fillojë pa vonesë, nëse duam që rezultatet të përfshihen në shqyrtimin tarifor 2026-2028. Ne kërkojmë prova të verifikueshme për të mbështetur vlerësimet e KRU-ve për humbjet aparente dhe teknike, përpara dorëzimit të aplikacionit tarifor 2026-2028, pra deri në mes të vitit 2025. Dështimi për të siguruar këto evidenca, do ta shtyjë ARRdo të bëjë supozime, për të cilat ARRU do të jetë në favor të konsumatorëve.

ARRU nuk pret që humbjet komerciale (aparente) të reduktohen në nivele pothuajse zero menjëherë, por kjo mund të zgjasë përgjatë disa cikleve të shqyrtimit tarifor. ARRU do të vendosë objektiva për një reduktim të humbjeve aparente në baza vjetore, p.sh. një reduktim prej 15% - 25% të humbjeve aparente gjatë periudhës së parë tre-vjeçare. Këto objektiva përfshihen në modelin e përcaktimit të tarifave, që do të rezultojë me tarifa më të ulëta se që do të ishin pa përfshirje të kësaj komponente. Nëse KRU-të nuk përmbushin këto objektiva, kjo do të rezultojë në ulje të fitimeve. Në të kundërtën, nëse i tejkalojnë këto objektiva, ato do të gjenerojnë fitime shtesë.

Pasi KRU-të të kenë përcaktuar nivelin e humbjeve aparente dhe teknike, ARRU kërkon që KRU-të të përgatisin listën e prioritetëve, me ato aktivitete që ofrojnë përfitim maksimal për konsumatorët, qoftë në tarifa më të vogla, qoftë në nivele të përmirësuara të shërbimit, si prioriteti më i lartë. Ne parashikojmë që reduktimi i humbjeve aparente do të ofrojë përfitimin më të madh neto për konsumatorët.

Paralelisht me reduktimin e humbjeve komerciale ne kërkojmë që KRU-të të ndërmarrin aktivitete të dizajnuara për të reduktuar humbjet teknike në nivelet e tyre ekonomike, pra '*nivelin ekonomik të humbjeve*'. Kjo do të përfshijë përmirësimin e menaxhimit të presionit dhe kontrollin aktiv të humbjeve. ARRU është duke shqyrtuar se cilat masa rregullatore detyruese janë në dispozicion, nëse KRU-të nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për të reduktuar humbjet teknike.

Si përfundim:

1. ARRU kërkon nga KRU-të të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të përcaktuar pa vonesë nivelin e humbjeve aparente (komerciale).
2. Tarifat për ciklin tarifor 2026-2028 do të përfshijnë komponentën e reduktimit të humbjeve aparente (komerciale). Nëse KRU-të nuk ndërmarrin aktivitetet e nevojshme, ARRU do të bëjë supozime për nivelin e humbjeve aparente (komerciale) që do të jenë në mbështetje të konsumatorëve.
3. KRU-të duhet t'i japin përparësi veprimeve të tyre të reduktimit të humbjeve për të maksimizuar përfitimin e konsumatorëve, për të cilat konsiderojmë se reduktimi i humbjeve aparente (komerciale) është përparësia më e lartë, përderisa KRU-të nuk mund të japin prova për të kundërtën.

4. ARRU gjithashtu u kërkon nga KRU-të të fillojnë të marrin masa për të reduktuar humbjet teknike në *'niveлин ekonomik të rumbjeve'* nëpërmjet reduktimit të presionit, kontrollit aktiv të rrjedhjeve dhe masave të tjera

Këto aktivitete duhet të fillojnë pa vonesë.

Me respekt,